



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, më 26 gusht 2019  
Nr. ref.:RK 1422/19

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI160/18**

Parashtrues

**Interpress R. Company**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të  
Kosovës, Rev.nr.163/2018, të 4 majit 2018**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga kompania Interpress R. Company (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) e përfaqësuar nga Valon Hasani, avokat nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme [Rev. nr. 163/2018] të 4 majit 2018 në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 4821/16] të 28 gushtit 2017 dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë [C.nr.1395/13] të 20 janarit 2016.
3. Aktvendimi i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 3 korrik 2018.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar me të cilin pretendohet se Kompanisë parashtruese i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 [E drejta për një Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 17 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 23 tetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërzhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
8. Më 7 nëntor 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e saj iu dërgua Gjykatës Supreme të Kosovës.
9. Më 23 korrik 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Parashtruesi i kërkesës në cilësi të paditësit më 26 tetor 2001, në atëherë Gjykatën Komunale në Prishtinë, kishte paraqitur padi kundër të paditurës Republikës së Serbisë, për dëmshpërblim, ndërsa më 27 tetor 2008 kishte

precizuar padinë duke kërkuar që e paditura në emër të dëmshpërblimit t'ia paguaj shumën prej 21.131.500., dollarë amerikan si kundërvlerë të dëmtimeve me djegie dhe 250.000 dollarë amerikan në emër të fitimit të humbur për çdo vit duke filluar nga 24 marsi 1999. Parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar që të gjitha shpenzimet t'i paguhen në afat prej pesëmbëdhjetë 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës.

11. Më 20 janar 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktvendim C.nr. 1395/13) e hodhi poshtë të palejuar padinë e Kompanisë parashtruese të paraqitur kundër palës së paditur, Republikës së Serbisë. Gjykata Themelore e shpalli veten jo kompetente për ta gjykuar çështjen duke arsyetuar: *“se është parim i së drejtës ndërkombëtare për zgjidhjen e kontesteve të shtetasve të huaj që gëzojnë të drejtën e së drejtës ndërkombëtare për zgjedhjen e kontesteve të shtetasve të huaj që gëzojnë të drejtën e imunitetit dhe për zgjidhjen e kontesteve të shtetasve të huaja dhe të organizatave ndërkombëtare vlejshme rregullat ndërkombëtare dhe se gjykata e vendit mund ti gjykojë këto konteste vetëm në ato raste kur kompetenca e vendit me element ndërkombëtar është paraparë shprehimisht me ligj apo me kontratë ndërkombëtare, apo në rastet kur të paditurit-shtetasit e huaj, shtetet e huaja apo organizatat ndërkombëtare kanë dhënë pëlqimin e tyre që mund të jenë palë e paditur në gjykatën e vendit.”*
12. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit material me propozim që aktvendimi i goditur të priset dhe çështja t'i kthehet gjykatës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.
13. Më 28 gusht 2017, Gjykata e Apelit (Aktvendim Ac. nr.4821/16) e refuzoi të pabazuar ankesën e Kompanisë parashtruese ndërsa aktvendimin e goditur të Gjykatës Themelore e vërtetoi. Gjykata e Apelit e miratoi vendimin e Gjykatës Themelore duke e konsideruar të drejtë dhe të ligjshëm. Gjykata e Apelit më tej shtoi, se: (i) pala e paditur, Republika e Serbisë, nuk mund të paditet në gjykatat e Republikës së Kosovës; dhe, (ii) aktualisht nuk është lidhur kurrfarë marrëveshje ndërkombëtare që përcakton kompetencën e gjykatave vendore për të gjykuar këtë lloj kontestesh.
14. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale me propozim që revizioni të miratohet i bazuar, ndërsa aktvendimi i goditur të priset dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje. Parashtruesi i kërkesës po ashtu iu kishte referuar nenit 8.2 të Propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Plani i Ahtisaarit) duke pretenduar, se dispozita në fjalë, obligon Republikën e Kosovës “që të merr përsipër dëmshpërblimin e shkaktuar ndaj qytetarëve të saj nga Republika e Serbisë gjatë luftës së vitit 1999.”
15. Më 4 maj 2018, Gjykata Supreme (Aktvendim Rev.nr.163/2018) refuzoi të pabazuar revizionin e Kompanisë parashtruese të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit AC.nr. 4821/2016 të 28 gushtit 2017. Gjykata

Supreme miratoi vendimet e gjykatave të instancës më të ulët duke i vlerësuar të drejta dhe të ligjshme.

16. Për sa i përket kompetencës së gjykatave për ta gjykuar çështjen e parashtruesit të kërkesës, pjesa relevante e aktvendimit të Gjykatës Supreme përcakton: *“Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoi, se gjykatat’ e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitën e nenit 18.3 të LPK-së, me të cilën është paraparë që kur gjykata gjatë procedurës konstaton se për zgjedhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata e vendit, do të shpallet in kompetente, do t’i shpallë të pa vlefshme të gjitha veprimet procedurale të kryera dhe do ta hedhë poshtë padinë që i është paraqitur. Mirëpo gjykata nuk do të veproj ashtu nëse kompetenca e gjykatës së vendit tonë varet nga pëlqimi i të paditurit, e i padituri e ka dhënë pëlqimin e vet. Kështu, gjykatat e instancës më të ulët kanë konstatuar se çështja e parashtruar me padi nuk bie në kompetencë të ndonjë gjykatë të vendit, andaj gjykata e shkallës së parë ka hedh poshtë si të pa lejueshme padinë e paditësit. Ky qëndrim juridik i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë është i pranueshëm për faktin se në rastin konkret, vijnë në shprehje normat e kolizionit të ligjit, sipas të cilave themelohet kompetenca e ndonjë gjykate të ndonjë vendi tjetër, dhe në bazë të dispozitës së nenit 28.2 të LPK-së, kur është fjala për kontestet me element të huaj, gjykata e vendit është kompetente vetëm nëse kjo kompetencë ndërkombëtare rrjedh shprehimisht nga ndonjë marrëveshje ndërkombëtare ose nga vet Ligji.”*
17. Për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për obligimet që rrjedhin nga dispozita e nenit 8.2 të Planit të Ahtisaarit për Republikën e Kosovës, Gjykata Supreme shpjegoi: *“[...] nga arsyet e sipër cekura edhe nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dyta ashta në kundërshtim me të drejtën materiale, gjegjësisht me parimin e suksesionit të përgjithshëm për shkak se me rastin e Pavarësisë së Kosovës, nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës, qartësisht janë marre përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që janë krijuar nga pushteti i atëhershëm serb, ashtu siç është parapara me nenin 8.2 të Pakos së Ahtisarit Gjykata Supreme vlerëson se në revizion bëhet keqinterpretimi i kësaj çështjeje, përkatësisht i nenit 8.2 të Propozimit Gjithë Përfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2001 (Pakoja e Ahtisarit), kjo ngase sipas kësaj dispozite, Republika e Kosovës nuk ka marrë përsipër obligimin e dëmshpërblimit të shkaktuar qytetareve të saj nga ana e Republikës së Serbisë gjatë konfliktit ushtarak në vitin 1999.”*

### **Pretendimet e Kompanisë parashtruese**

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i Gjykatës Supreme [Rev.nr.163/2018] i 4 majit 2018 në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 4821/16] të 28 gushtit 2017 dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë [C.nr. 1395/13] të 20 janarit 2016, shkel të drejtat e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuara me nenet 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon: “... se në rastin konkret Republika e Serbisë nuk gëzon imunitet në procedurat gjyqësore që zhvillohen në gjykatat e Republikës së Kosovës për shkak se: (a) nuk ka asnjë marrëveshje ndërkombëtare e cila e detyron Republikën e Kosovës që ti ofroj imunitet Republikë së Serbisë ne procedurat gjyqësore që zhvillohen kundër kësaj te fundit ne gjykatat e Republikës se Kosovës; (b) e drejta zakonore ndërkombëtare, nuk e detyron shtetin e Republikës së Kosovës që ti ofroj imunitet Republikës së Serbisë në procedurat që zhvillohen kundër kësaj të fundit në gjykatat e Republikës së Kosovës; (c) Republika e Serbisë asnjëherë nuk është thirrur se ka imunitet ndaj procedurave që zhvillohen në gjykatat e Republikës së Kosovës.”
20. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon: “Procedura në rastin konkret është stërzgjatur sepse padia është paraqitur në gjykatë në vitin 2001, ndërsa vetëm në vitin 2018 është vendosur përfundimit nga ana e gjykatave të rregullta se këto të fundit nuk janë kompetente për ta shqyrtuar këtë lëndë. Për vendosjen e një çështje procedurale gjykatave të rregullta u janë dashur 17 vite. Padyshim se kjo procedurë është ne kundërshtim me Nenin 6 të KEDNJ si dhe Nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ngase ky gjykim nuk është vendosur brenda një afati të arsyeshëm.”
21. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që kërkesa të shpallet e pranueshme dhe që Aktvendimi i Gjykatës Supreme të shpallet i pavlefshëm dhe “të detyrojë këtë të fundit që të rishqyrtojë revizionin e palës referuese.”

### **Vlerësimi i pranueshmërisë se kërkesës**

22. Gjykata se pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuar me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

24. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashohin:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individidi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... .”*

25. Për sa i përket përbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme [Rev.nr.163/2018] e 4 majit 2018, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
26. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përbushur kriteret e pranueshmërisë të specifikuar në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) specifikon:
- “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*
27. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave të garantuara me nenet 31 dhe 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
28. Në adresimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata thekson se pretendimet thelbësore që kanë të bëjnë me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, janë interpretuar hollësisht

përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, në interpretimin e pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

29. Gjykata thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe po ashtu edhe praktika gjyqësore e saj udhëhiqen nga parimi se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 6 dhjetorit 1988, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, nr. 10590/83, paragrafi 68; shih gjithashtu, rastin e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe rastin KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për Papranueshmërisë i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).
30. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e Republikës së Kosovës kanë juridiksion për ta gjykuar rastin e saj sepse nuk ekziston ndonjë normë e të drejtës ndërkombëtare, qoftë e përcaktuar me ndonjë marrëveshje ndërkombëtare apo nga e drejta zakonore ndërkombëtare që detyron gjykatat e Republikës së Kosovës t'i japin imunitet shtetit serb, aq më tepër, kur ky i fundit *“asnjëherë nuk është thirrur se ka imunitet ndaj procedurave që zhvillohen në gjykatat e Republikës së Kosovës.”*
31. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta kanë qenë të stërzgjatura në kundërshtim me standardet e përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
32. Gjykata vëren se Gjykata Supreme i është përgjigjur pretendimeve qendrore të parashtruesit të kërkesës: (i) duke shpjeguar shkaqet e “inkompetencës” së gjykatave të rregullta; (ii) duke interpretuar dispozitat ligjore përkatëse që rregullojnë çështjet me elementë ndërkombëtarë; dhe (iii) duke dhënë arsyetimin se përse dispozita e nenit 8.2 të Planit të Ahtisaarit është keqinterpretuar nga parashtruesi i kërkesës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet pjesës relevante të vendimit të Gjykatës Supreme që përcakton: *“Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoi, se gjykatat' e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitën e nenit 18.3 të LPK-së, me të cilën është paraparë që kur gjykata gjatë procedurës konstaton se për zgjedhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata e vendit, do të shpallet in kompetente, do t'i shpallë të pa vlefshme të gjitha veprimet procedurale të kryera dhe do ta hedhë poshtë padinë që i është paraqitur. Mirëpo gjykata nuk do të veproj ashtu nëse kompetenca e gjykatës së vendit tonë varet nga pëlqimi i të paditurit, e i padituri e ka dhënë pëlqimin e vet. Kështu, gjykatat e instancës më të ulët kanë konstatuar se çështja e parashtruar me padi nuk bie në kompetencë të ndonjë gjykatë të vendit, andaj gjykata e shkallës së parë ka hedh poshtë si të pa lejueshme padinë e paditësit. Ky qëndrim juridik i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë është i pranueshëm për faktin se në rastin konkret, vijnë në shprehje normat e kolizionit të ligjit, sipas të cilave themelohet kompetenca e ndonjë gjykate të ndonjë vendi tjetër, dhe në bazë të dispozitës së nenit 28.2 të*

*LPK-së, kur është fjala për kontestet me element të huaj, gjykata e vendit është kompetente vetëm nëse kjo kompetencë ndërkombëtare rrjedh shprehimisht nga ndonjë marrëveshje ndërkombëtare ose nga vet Ligji [...] nga arsyet e sipër cekura edhe nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dyta është në kundërshtim me të drejtën materiale, gjegjësisht me parimin e suksesionit të përgjithshëm për shkak se me rastin e Pavarësisë së Kosovës, nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës, qartësisht janë marre përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që janë krijuar nga pushteti i atëhershëm serb, ashtu siç është parapara me nenin 8.2 të Pakos së Ahtisarit Gjykata Supreme vlerëson se në revizion bëhet keqinterpretimi i kësaj çështjeje, përkatësisht i nenit 8.2 të Propozimit Gjithë Përfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2001 (Pakoja e Ahtisarit), kjo ngase sipas kësaj dispozite, Republika e Kosovës nuk ka marrë përsipër obligimin e dëmshpërblimit të shkaktuar qytetareve të saj nga ana e Republikës së Serbisë gjatë konfliktit ushtarak në vitin 1999.”*

34. Sa më sipër, Gjykata vëren se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ai ka mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqes argumente dhe dëshmi që ai i konsideroi relevante për rastin e tij; se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës Nr. KI118/17, Parashtrues *Sani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih, *mutatis mutandis*, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).
35. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe shih, gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
36. Sa i përket obligimeve të Republikës së Kosovës lidhur me dëmet e shkaktuara nga shteti serb, Gjykata po ashtu vë në pah edhe praktikën e saj gjyqësore të ndërtuar mbi praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ku është potencuar se ekzistojnë barriera procedurale të cilat i imponon parimi i imunitetit sovran të shteteve – si një nga parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare publike – në raport me procedurat gjyqësore që mund të zhvillohen kundër një shteti në gjykatat e brendshme të një shteti tjetër (shih rastet e bashkuara të Gjykatës Kushtetuese, KI96/18, KI97/18, KI98/18, KI99/18, KI100/18, KI101/18,



KI102/18, KI103/18, KI104/18, KI105/18, KI106/18, KI107/18, KI116/18, KI117/18, KI119/18 dhe KI125/18, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 janarit 2019, paragrafët 58 dhe 59, shih, *mutatis mutandis*, edhe rastet e GJEDNJ-së, *Jones dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, ankesat nr. 34356/06 dhe 40528/06, Aktgjykimi i 14 janarit 2014 dhe *Al-Adsani kundër Mbretërisë së Bashkuar*, ankesa nr. 35763/97 Aktgjykimi i 21 nëntorit 2001).

37. Veç kësaj, në rastin *Al-Adsani kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ ka argumentuar si në vijim: “*E drejta e qasjes në gjykatë mund t’i nënshtrohet kufizimeve, nëse nuk preket thelbi i së drejtës. Kufizime të tillë duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe të jenë proporcionale. Njohja e imunitetit sovran të shteteve në procedura civile ndjekë qëllimin legjitim të respektimit të së drejtës ndërkombëtare [...]. Për sa i përket proporcionalitetit, për sa është e mundur, Konventa duhet të interpretohet në harmoni me rregullat tjera të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me imunitetin e shteteve. Kështu, masat e ndërmarra nga shteti të cilat pasqyrojnë rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare mbi imunitetin e shteteve, në parim, nuk mund të shikohen si kufizim joproporcional i të drejtës për qasje në gjykatë*”. Një qëndrim të tillë, për sa i përket tensionit në mes të parimit të imunitetit sovran të shteteve dhe të drejtës për qasje në drejtësi (gjykatë), e ka theksuar edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (shih, për shembull, rastin: *Gjermania kundër Italisë; Greqia si palë intervenuese*, Aktgjykimi i 3 shkurtit 2012, dhe shih *Ibidem*, rastet e bashkuara të Gjykatës Kushtetuese, paragrafët 58-59).
38. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës në gjykatat të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrëjë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
39. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për stërzgjatje të procesit, Gjykata vëren se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se kjo çështje është ngritur nga parashtruesi i kërkesës gjatë procedurës së rregullt. Kjo çështje është ngritur për herë të parë në Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese - në pajtim me parimin e subsidiaritetit - nuk mund ta vlerësojë këtë çështje pa qenë paraprakisht e ngritur dhe vlerësuar nga gjykatat e rregullta (shih Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: rasti nr. KI89/15 *Parashtrues Fatmir Koci*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 22 marsit 2016, paragrafi 35).
40. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, ankesa nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

41. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të shpallet e papranueshme, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 23 korrik 2019, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtar raportues**

Nexhmi Rexhepi

**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Arta Rama-Hajrizi

